



Raporti Vjetor Narrativ

Viti 2023

Zbatuar nga YWCA of Albania

Rr. Him Kolli,

Tirana, Albania

Tel: 00355 42271642

HYRJE

YWCA of Albania vazhdon të jetë e përkushtuar në përmbushjen e misionit të saj për të rritur ndërgjegjësimin, për të ofruar mbështetje dhe për të investuar në ngritjen e kapaciteteve, nëpërmjet konsolidimit të rrjeteve të bashkëpunimit. Organizata jonë ka si synim angazhimin e grave, të rinjve dhe fëmijëve, në iniciativa të ndryshme për të advokuar për drejtësi, paqe, shëndet, dinjitet, të drejta, liri dhe përkujdesje ndaj mjedisit.

Në përputhje me objektivat e saj, YWCA ka ofruar mbështetje për komunitetet vulnerable, veçanërisht gratë që përballen me sfida të ndryshme, si të ardhura të pakta, kanceri i gjirit, nevoja të veçanta, dhunë apo/dhe trafikim të qenieve njerëzore. Promovimi i lidershit të grave dhe ofrimi i shërbimeve specifike për t'i mbështetur ato janë strategji qendrore për adresimin efektiv të këtyre çështjeve. Gjithashtu, shëndeti mendor dhe mbështetja psikologjike kanë qenë prioritet i organizatës, ku YWCA vazhdon të ofrojë seanca këshillimi online falas për gratë e diagnostikuara me kancer gjiri dhe familjarët e tyre.

YWCA of Albania ka qenë dhe vazhdon të jetë një shtëpi e madhe për të gjitha moshat dhe grupet e njerëzve, pa përjashtim. Takimet midis anëtarëve dhe vullnetarëve të YWCA, trajnimet profesionale, punësimi, rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me shëndetin mendor, mbështetja e familjeve me të ardhura të pakta, fushatat e vazhdueshme të lidhura me kancerin e gjirit, promovimi i barazisë gjinore, fuqizimi i grave si faktorë kryesorë me qëllim parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, prezantimi i teknikave pozitive të disiplinimit, fokusi tek edukimi, krijimi i koalicioneve me bazë komunitare me qëllim parandalimin e drogës dhe alkoolit, si dhe ofrimi i shërbimeve për komunitetin afgan nëpërmjet Qendrës Ditore në Lezhë, kanë qenë disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara nga YWCA.

Ky raport vjetor paraqet impaktin që investimi dhe përfshirja e YWCA ka patur tek gratë, fëmijët dhe të rinjtë. Duke forcuar kapacitetet dhe duke mundësuar mjetet e duhura për mirëmenaxhimin e punës, YWCA ka ofruar në mënyrë efektive shërbime dhe programe për komunitetin. Puna e YWCA of Albania bazohet në vlera specifike, si integriteti, toleranca, respekti dhe gjithëpërfshirja. Arritjet e përshkruara në këtë periudhë raportimi nuk do të kishin qenë të mundura pa mbështetjen e vazhdueshme të anëtarëve të bordit, stafit, vullnetarëve, partnerëve dhe donatorëve.

Sinqerisht,

Donika Godaj

Drejtore Ekzekutive

PROGRAMET E YWCA OF ALBANIA

QËLLIMI 1: TË VAZHDOJË TË PROMOVOJË ROLIN E LIDERSHIPIT TË GRAVE SHQIPTARE PËRMES INFORMIMIT, EDUKIMIT DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

Projekti 1.1: Fuqizimi i rrjeteve lokale të grave për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, si një mekanizëm për të krijuar komunitete vigjilente dhe kohezive

YWCA of Albania ka zbatuar projektin “Fuqizimi i rrjeteve lokale të grave për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, si një mekanizëm për të krijuar komunitete vigjilente dhe kohezive” në bashkitë e Kavajës, Kukësit, Lezhës dhe Beratit. Kjo iniciativë është krijuar bazuar në qasjen gjinore për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe bazohet në punën e mëparshme të YWCA në këtë fushë.

YWCA of Albania ka vendosur të përdorë një qasje gjinore për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm sepse:

- Gratë janë shpesh viktime të veprimeve të grupeve të dhunshme ekstremiste.
- Gratë, si kujdestare kryesore mund të evidentojnë më lehtësisht shenjat e hershme të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm mes anëtarëve të familjes nëse janë të informuara dhe të fuqizuara.
- Gratë mund të shërbejnë si modele pozitive dhe promovuese të paqes, barazisë dhe vlerave demokratike
- Angazhimi i drejtpërdrejtë i grave në akte të dhunshme ekstremiste është ulur gjatë tridhjetë viteve të fundit.
- Në disa raste, gratë ndjekin bashkëshortët ose anëtarët e tjerë meshkuj të familjes në grupe terroriste, pa pasur mundësi zgjedhje për shkak të mungesës së informacionit dhe mbështetjes.
- Gratë kanë më shumë gjasa se burrat të bien dakord që njerëzit që i përkasin feve të ndryshme duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Për këtë arsye, YWCA of Albania ka krijuar katër *rrjete lokale të grave* në katër bashki të ndryshme: Kavajë, Kukës, Berat dhe Lezhë. Këto rrjete kanë pasur një përfaqësim të gjerë të profileve të grave, si përfaqësuese të institucioneve arsimore, përfaqësuese të strukturave, OJQ-ve, përfaqësuese të policisë, mediave, si dhe aktiviste të komuniteteve përkatëse.

Si pjesë e projektit janë zhvilluar një sërë aktivitete, duke përfshirë takime me gra, pjesë e rrjeteve lokale të grave, takime me të rinj, trajnime, takime me komunitetin, takime me gra me të ardhura të pakta, etj. Gjithashtu në fund të iniciativës është realizuar një konferencë përmbyllëse, e cila ka shërbyer për të ndarë praktikat më të mira dhe për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm midis grave dhe vajzave që konsiderohen si agjente kryesore në parandalimin dhe raportimin e ekstremizmit.

Nëpërmjet bashkëpunimit me rrjetet lokale të grave, stafin lokal, pushtetin lokal dhe qendror, OJF të tjera etj., janë arritur këto rezultate:

- Krijimi i **katër rrjeteve lokale të grave**
- **1 Info Dokument** i hartuar dhe shpërndarja e rreth 800 kopjeve tek bashkitë e projektit
- Krijimi i **profilit të grave**, si një strategji që mund të aplikohet në iniciativa të ndryshme
- Trajnimi dhe fuqizimi i **100 grave** mbi ekstremizmin e dhunshëm
- Angazhimi aktiv i **100 grave** në shoqëri, sipas planit të rrjetit lokal të grave
- Krijimi i një **web-menu specifike** për parandalimin dhe adresimin e ekstremizmit të dhunshëm në faqet zyrtare të Drejtorive të Shërbimeve Sociale në çdo bashki
- Fuqizimi dhe informimi i rreth **1000 vajzave dhe grave**, përmes mënyrave të drejtpërdrejta ose të tërthorta të komunikimit (takime joformale, media sociale, video, broshura)
- Nënshkrimi i **4 Memorandumeve të Bashkëpunimit**
- Realizimi i **Ditëve të Hapura Informative**
- **Rritje dhe konsolidim** i bashkëpunimit mes strukturave lokale dhe përfaqësuesve të ndryshëm të komunitetit
- Ndarje e informacionit tek target grupi për të njohur dhe parandaluar **ideologjitë** dhe **veprimet** që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm
- Rritje e **vullnetarizmit** për të promovuar vlerat e paqes, demokracisë dhe barazisë
- Rritje e **vetëvlerësimit** të grave vulnerabël të përfshira në iniciativë

- Identifikim i *praktikave më të mira* për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm
- Rritje e *angazhimit të grave* në çështjet sensitive në shoqëri, përmes krijimit të rrjeteve lokale



QËLLIMI 2: TË VAZHDOJË TË MUNDËSOJË INFORMIMIN, EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE, PËR T'Ë FUQIZUAR ATO NË ASPEKTIN KULTUROR DHE SOCIAL

Projekti 2.1: Zgjerimi dhe përmirësimi i programit të shërbimit të bibliotekës

Projekti i Bibliotekës lidhet me qëllimet kryesore të YWCA për emancipimin e grave dhe vajzave duke promovuar pasionin për leximin e librave, si një formë trajnimi për të mundësuar rritje kulturore dhe sociale, por gjithashtu edhe për të sjellë ndryshime pozitive në jetën e tyre. Për shkak të situatës së vështirë

ekonomike në Shqipëri njerëzit lexojnë më pak, kështu që puna jonë synon të përfshijë gra dhe vajza të të gjitha moshave.

Biblioteka e YWCA përmban libra të kategorive të ndryshme: libra klasikë, libra nga autorë shqiptarë, libra psikologjikë, filozofikë dhe sociologjikë; libra mjekësorë; libra në gjuhë të huaj, libra historikë, etj. Një fokus të rëndësishëm në bibliotekën tonë, kanë librat për fëmijë, me tregime dhe përralla, por edhe me udhëzime për prindërit dhe mësuesit, për rritjen e shëndetshme dhe edukimin. Në bibliotekën tonë, mund të keni akses tek autorët më të mirë shqiptarë dhe të huaj. Aktualisht biblioteka ka **3,500** libra.

Librat kanë një *ndikim të madh në fuqizimin e grave dhe vajzave* sepse ndikojnë pozitivisht në aspektin emocional dhe psikologjik; japin mundësi për të mësuar gjëra të reja, për të eksploruar ide të reja, si dhe për të zgjeruar njohuritë. Përmes librave, gratë mund të zbulojnë vetveten, sepse çdo libër i mirë hap dimensione të reja mendimesh për lexuesin. Projekti i Bibliotekës synon të përmirësojë shëndetin emocional të lexuesve, pasi librat karakterizohen nga prania e shumë emocioneve. Pra, librat janë pa dyshim një burim i madh motivimi. Gratë mund të *frymëzohen* nga to dhe të transformojnë jetën e tyre pozitivisht. Gratë kanë nevojë për akses në libra që nxisin imagjinatën e tyre dhe u ngjallin interes, në mënyrë që të nxiten që të vazhdojnë të lexojnë përgjatë gjithë jetës së tyre. YWCA do të vazhdojë të vendosë një fokus të veçantë në *edukimin e grave dhe vajzave, si mënyra kryesore për t'i fuqizuar ato.*



QËLLIMI 3: TË OPEROJË SI NJË NGA ENTITETET MË TË MIRA NË PRAKTIKË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ARSIMIT CILËSOR PËR FËMIJËT

Projekt 3.1: “Qendrat e Fëmijërisë së Hershme, si hapësira të sigurt dhe kreative!”

“Qendrat e Fëmijërisë së Hershme, si hapësira të sigurt dhe kreative!” është një projekt i zbatuar nga YWCA of Albania me mbështetjen e UNICEF.

Në mes të tetorit të vitit 2021, rreth 500 afganë, përfshirë të rritur dhe fëmijë, mbërritën në Shqipëri. Gjatë vitit 2022, popullsia afgane u akomodua në dy resorte në qytetet e Durrësit dhe Lezhës. Rreth 40% e të evakuarve kanë qenë fëmijë (rreth 640 fëmijë që janë strehuar fillimisht tek dy resortet). Si përgjigje ndaj situatës, qëllimi kryesor i projektit ka qenë ngritja e **dy Qendrave Ditore** në Lezhë dhe Durrës për të shërbyer si vende të sigurta dhe kreative për fëmijët afganë dhe prindërit e tyre.

Në fillim të projektit, YWCA of Albania ka krijuar dy Qendra Ditore: një në Durrës dhe një në Shëngjin. Megjithatë, për shkak të përqendrimit të një numri më të madh të refugjatëve afganë në Shëngjin, gjatë vitit 2023, funksionale vazhdon të mbetet Qendra Ditore në Shëngjin, duke ofruar një sërë shërbimesh.

E gjithë filozofia e Qendrës Ditore bazohet në **qasjen joformale të të mësuarit**. Edukimi joformal ka në qendër nxënësit dhe konsiderohet si forma më e mirë e të mësuarit, veçanërisht për fëmijët parashkollorë. Gjithashtu, të mësuarit nëpërmjet lojës është shumë efektiv, veçanërisht për fëmijët që janë përballur me situata të vështira dhe traumatike, si në rastin e fëmijëve afganë.



YWCA of Albania ka një fokus të veçantë në **fuqizimin e prindërve afganë**. Për të adresuar nevojat e tyre, YWCA zhvillon takime periodike me ta, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për strategjitë më të mira të prindërimit dhe për t'i përfshirë në mënyrë aktive në programet e Qendrës Ditore. Prindërit janë njohur me një sërë temash për shëndetin mendor, disiplinën pozitive, rëndësinë e lojës, zhvillimin dhe të drejtat e fëmijëve, etj.

Gjithashtu, YWCA of Albania ka zhvilluar sesione trajnimi me **mësues dhe edukatorë** të ciklit parashkollor. Temat e sesioneve kanë pasur në fokus të mësuarit socio-emocional; qëllimet arsimore; disiplinën pozitive; reziliencën e fëmijëve; zhvillimin e fëmijëve parashkollorë; qasjet me në qendër

fëmijën; parimet e vëzhgimit; procesin akademik me fëmijët e prekur nga ngjarje traumatike; parimet etike etj. Trajnimet kanë shërbyer për rritjen e kapaciteteve të mësueseve dhe edukatoreve të ciklit parashkollor, duke kontribuar në suksesin e programit.

Angazhimi në **aktivitete psikosociale** i fëmijëve parashkollorë është thelbësor për zhvillimin e tyre holistik. Për këtë arsye, mbështetja psikologjike mbetet një shërbim që vazhdon të ofrohet në Qendrën Ditore. Nëpërmjet lojërave, tregimit të historive dhe aktiviteteve sociale, fëmijët kanë mësuar të shprehin emocionet e tyre, të krijojnë miqësi dhe të zhvillojnë empatinë.

YWCA of Albania ka zgjeruar gamën e aktiviteteve të saj duke ofruar shërbime në kopshtin publik lokal në Shëngjin. Këto shërbime konsistojnë në: aktivitete me fëmijët parashkollorë, aktivitete psikologjike; aktivitete me prindër, takime ndërgjegjësuese dhe informuese; aktivitete me mësuesit dhe diskutime të hapura. Gjithashtu, YWCA ka zhvilluar aktivitete të përbashkëta me prindër dhe fëmijë afganë dhe shqiptarë. Këto aktivitete synojnë integrimin, shkëmbimin kulturor dhe promovimin e bashkëjetesës së bazuar në vlerat e paqes, respektit dhe diversitetit.

YWCA of Albania ka publikuar **histori njerëzore** në lidhje me shërbimet e ofruara nga Qendra Ditore në Lezhë. Historitë, të shkruara në bazë të intervistave dhe vëzhgimeve të drejtpërdrejta, kanë eksploruar çështjet kryesore të lidhura me fëmijët dhe prindërit afganë. Historitë janë publikuar në webin dhe rrjetet sociale të YWCA dhe UNICEF dhe kanë pasur një impakt të gjerë në komunitet.

Përveç kësaj, ne kemi lançuar një **seri podcastesh** të titulluar "Nga Kabuli tek Qendra Ditore", që fokusohet tek rezilienca e komunitetit afgan dhe mikpritja e komunitetit shqiptar. Nëpërmjet tregimeve prekëse, podcastet synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e ofrimit të një mjedisi të sigurtë dhe edukativ për të gjithë fëmijët, përfshirë edhe fëmijët e zhvendosur për shkak të situatave konfliktuale.

Gjithashtu, me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin, YWCA ka prodhuar një sërë **botimesh**, si manuale mbi prindërimin pozitiv, të drejtat e fëmijëve, broshura mbi zhvillimin, ushqyerjen e shëndetshme, higjienën, etj.

Nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të YWCA of Albania dhe partnerëve të saj, projekti "*Qendrat e Fëmijërisë së Hershme si Hapësira Kreative dhe të Sigurta!*" po krijon në mënyrë të vazhdueshme një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës për fëmijët dhe familjet afgane, duke rritur rezilencën e tyre, duke përmirësuar të mësuarit dhe duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë.



QËLLIMI 4: PROGRAMET EDUKATIVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE - TË RRISE NËNDËRGJEGJËSIMIN MBI SHËNDETIN DHE KANCERIN E GJIRIT

Projekti 4.1: Fushata ndërgjegjësuere mbi kancerin e gjirit

YWCA of Albania ka përmbyllur fushatën e 15-të kundër kancerit të gjirit, nën sloganin “Fjongo rozë më kujton...”. Fushata e 15-të ka shënuar një moment historik të rëndësishëm në përpjekjet tona të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin, promovimin e zbulimit të hershëm dhe mbështetjen e individëve të prekur nga kanceri i gjirit. Gjatë 15 viteve të fundit, ne kemi qenë dëshmitarë të një progresi thelbësor në misionin tonë për të parandaluar dhe për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin për këtë sëmundje. Fushata “Fjongo rozë më kujton” fokusohet në përdorimin e simbolit të fjongos rozë, si një kujtesë për individët që të *ndërmarrin veprime dhe të qëndrojnë vigjilentë* në çështjet e lidhura me parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Ky raport gjithëpërfshirës pasqyron aktivitetet kryesore të fushatës, ndikimin e kauzës tek komuniteti dhe progresin e arritur ndër vite.

Falë mbështetjes së një sërë partnerësh dhe donatorësh, si *Hoffmann – La Roche LTD, Ambasada e SHBA-së-Tiranë, Bashkia Tiranë, Top Channel, OTP Bank Albania, Arté Boutique Hotel, Dominer, Credins Bank, NRG Radio, The Pilates LAB, UNFPA Albania, Hausbrandt, Albanian Design Academy, etj.* nën moton “Fjongo Rozë më kujton” janë realizuar një sërë veprimtarish me pjesëmarrjen aktive të vajzave dhe grave të diagnostikuara me kancer në gji, përfaqësuesve të komunitetit, medias, politikës, shëndetësisë etj.

Aktivitetet kryesore të fushatës:

- ***Këshillim psikologjik online falas:*** YWCA of Albania ka vazhduar të ofrojë këshillim psikologjik online falas për gratë e diagnostikuara me kancer në gji dhe familjarët e tyre gjatë gjithë vitit, duke mbështetur rreth 70 përfitues. Ky shërbim është shumë i rëndësishëm për adresimin e aspekteve emocionale dhe psikologjike, si dhe për të përmirësuar strategjitë përgjatë përballjes me kancerit të gjirit.
- ***Fushata në media sociale:*** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e mediave sociale, ne kemi vazhduar të edukojmë, mbështesim dhe frymëzojmë përgjatë gjithë vitit individët dhe komunitetet në luftën kundër kancerit të gjirit. Duke ndarë rregullisht postime informuese në të gjitha rrjetet sociale, ne kemi arritur një audiencë të gjerë dhe kemi rritur ndërgjegjësimin në mënyrë efektive.
- ***Aktivitet tek Spitali Onkologjik në Tiranë:*** Fjongo Rozë e YWCA u solidarizua me luftëtarët e kancerit të gjirit pranë Spitalit Onkologjik në Tiranë, duke dhënë shpresë dhe inkurajim. Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars, kemi shpërndarë materiale informuese, produkte të rëndësishme, si dhe kemi prezantuar platformën fjongoroze.al, e cila përdoret për realizimin e këshillimit psikologjik online falas.
- ***Letrat e grave me kancer në gji:*** Një element i ri i fushatës së këtij viti, kanë qenë letrat e shkruara nga të mbijetuarat e kancerit të gjirit, ku janë ndarë histori personale të përshtatura edhe në video. Letrat e shkruara kanë ndihmuar në ofrimin e mbështetjes edhe për gratë e tjera me përvoja të ngjashme, si dhe kanë shërbyer në rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin.
- ***Sfida "Vera e Fjongos Rozë":*** Fushata e vitit 2023 ka pasur pjesë të aktiviteteve sfidën "Vera e Fjongos Rozë", realizuar përgjatë periudhës qershor-gusht 2023. Sfida ka nisur me foton e ambasadores së kauzës Ermonela Jaho dhe është përkrahur nga një audiencë e gjerë.
- ***Angazhimi i të rinjve:*** Në bashkëpunim me shkollat dhe të rinjtë, janë realizuar aktivitete edukative të fokusuar në ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit. Nëpërmjet konkurseve, të rinjtë jo vetëm kanë përfituar njohuri të vlefshme, por i janë bashkuar kauzës për të promovuar strategjitë e nevojshme për parandalimin e kancerit të gjirit.
- ***Pilates në natyrë:*** Me qëllim promovimin e një stili jetese të shëndetshëm, është organizuar Pilates në natyrë, më qëllim përmirësimin e mirëqenies fizike dhe psikologjike. Kjo nismë ka nxitur

angazhimin e komunitetit dhe ka kontribuar në rritjen e përpjekjeve të përbashkëta për parandalimin e kancerit të gjirit.

- **Aktivite sportive:** Falë partneritetit me *Klubin Sportiv Partizani, Klubin Sportiv Tirana dhe Federatën Shqiptare të Basketbollit*, ne kemi përçuar përgjatë aktiviteteve sportive mesazhe rreth rëndësisë së informimit, ndërgjegjësimit dhe ndërmarrjes së veprimtarive ndaj kancerit të gjirit.
- **Ecja Ndërgjegjësuere në Tiranë:** Ecja Simbolike e YWCA, si një nga aktivitetet kulmore të fushatës “Fjongo Rozë më kujton” ka bërë bashkë partnerë, mbështetës, përfaqësues të strukturave të ndryshme, gra të diagnostikuara me kancer në gji, etj. Ky aktivitet, i realizuar në 23 tetor 2023, është simbol i solidaritetit dhe shpresës.

Ndërsa reflektojmë mbi arritjet e fushatës sonë të 15-të të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, YWCA of Albania thekson angazhimin për të vazhduar punën dhe për të risjellë ndryshime domethënëse në jetën e grave të prekura nga kanceri i gjirit. Mbështetja e palëkundur e partnerëve dhe komunitetit, na motivon për të vazhduar misionin tonë për të rritur ndërgjegjësimin, për të promovuar zbulimin e hershëm dhe për të ofruar shërbime mbështetëse jetike. Së bashku, ne vazhdojmë të bëjmë hapa përpara në luftën kundër kancerit të gjirit!

<https://fjongozoze.al/>





QËLLIMI 5: FUQIZIMI I KOMUNITETVE NËPËRMJET RITJES SË KAPACITETEVE, MBËSHTETJES, TRAJNIMEVE, SESIONEVE INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE

Projekti 5.1: Bashkitë mbështesin parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore përmes masave të integruara të mbrojtjes sociale.

Shqipëria vazhdon të përballlet me nivele të larta papunësie, ku grupet më të prekura janë të rinjtë dhe gratë. Faktorë të shumtë historikë dhe strukturorë kanë ndikuar jo vetëm në zhvillimin socio-ekonomik të vendit, por edhe në natyrën dhe rritjen e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, brenda dhe jashtë kufijve.

Trafikimi i qenieve njerëzore prek viktimat, viktimat potenciale, si dhe komunitetet ku ky fenomen ndodh. Për këtë arsye, programet e mbrojtjes sociale janë të rëndësishme për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, duke reduktuar faktorët e riskut që i bëjnë individët më vulnerabël. Nëpërmjet strategjive dhe shërbimeve të përshtatshme të mbrojtjes sociale, familjet dhe individët me të ardhura të pakta do të kenë më tepër akses tek shërbimet, që janë shumë të rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare. Programet e

përshtatshme të mbrojtjes sociale, mundësojnë riintegrim të plotë të viktimave të trafikimit, pasi reduktojnë barrierat strukturore për aksesin në shërbime.

Pavarësisht kornizës ligjore, evidencat tregojnë se familjet vulnerable dhe të varfra kanë informacion të pamjaftueshëm dhe kanë pengesa aksesin në të drejtat e mbrojtjes sociale. Kanalet e kufizuara të komunikimit, mungesa e besimit, procedurat e paqarta administrative konsiderohen si arsye për ulje të aksesit në shërbime. Nga ana tjetër, administratorët socialë kanë mjete dhe kohë të kufizuar për të ofruar informacion dhe për të lehtësuar aksesin. Barrierat në fushën e shërbimeve dhe të drejtave të lidhura me mbrojtjen sociale janë më sfiduese për viktimat e trafikimit, viktimat e mundshme dhe të rikthyerit.

Për këtë arsye, në bashkitë Kukës, Kamëz, Pukë dhe Bulqizë, YWCA of Albania është duke zbatuar projektin *“Bashkitë mbështesin parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore përmes masave të integruara të mbrojtjes sociale”*, me fokus fuqizimin e familjeve me ndihmë ekonomike për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore.

Përgjatë vitit 2023 janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Fuqizimi i **985** përfituesve nëpërmjet angazhimit në aktivitete
- Realizimi i **24** Ditëve të Hapura Informative me pjesëmarrjen e familjeve me ndihmë ekonomike, Shërbimeve Sociale, Zyrës së Punës, shëndetësisë, bashkisë, etj.
- Trajnimi i **93** punonjësve





Projekti 5.2: Krijimi i komuniteteve të shëndetshme, të sigurt dhe pa drogë në Shqipëri

Përgjatë vitit 2023, YWCA në bashkëpunim me CADCA ka vijuar me zbatimin e strategjisë parandaluese kundër përdorimit të alkoolit dhe drogës, me qëllim krijimin e komuniteteve të sigurt, të shëndetshme dhe pa drogë në pesë qytete: Tiranë, Shkodër, Berat, Kukës dhe Lezhë. Kjo iniciativë është fokusuar në mbledhjen e të dhënave, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe rritjen e vizibilitetit të punës së koalicioneve si një mjet për të angazhuar komunitetin dhe për të rritur ndërgjegjësimin.

Aktivitetet dhe arritjet kryesore:

- **Vlerësimi i komuniteteve:** Koalicionet realizuan procesin e vlerësimit të komuniteteve të tyre përmes pyetësorëve, vëzhgimeve dhe intervistave me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë nxënësit, prindërit, mësuesit dhe banorët e qytetit. Qëllimi ishte identifikimi i situatës aktuale në lidhje me përdorimin e substancave, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i strategjive të ndërhyrjes sipas kushteve lokale.
- **Vetimi i anëtarëve të koalicioneve:** Sipas qasjes së CADCA, YWCA of Albania është angazhuar në procesin e vetimit të të gjithë anëtarëve të koalicioneve të cilët marrin pjesë në trajnime, duke përfshirë këtu përfaqësuesit e zbatimit të ligjit dhe individë nga sektorët e tjerë të komunitetit. Ky element siguroi integritetin dhe efektivitetin e anëtarëve të koalicionit.
- **Takimet informale:** Koalicionet organizuan takime informale me pjesëmarrës nga background-e të ndryshme, duke përfshirë përfaqësues nga qendrat komunitare, OJF-të, drejtoritë vendore të policisë, stafet e bashkive, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe shkollat. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan tema të

ndryshme lidhur me nevojën për mbështetje nga institucionet vendore, integritetin e grupit, analizën e të dhënave dhe përfshirjen e anëtarëve të rinj.

- **Rishikimi i anëtarësimit:** Duke patur në fokus gjithëpërfshirjen, koalicionet kanë punuar për rekrutimin e më shumë përfaqësuesve nga të gjithë sektorët e komunitetit, veçanërisht duke i dhënë përparësi sektorëve që nuk kishin përfaqësim. Përfshirja e të rinjve ishte një nga objektivat kryesore dhe shumë nxënës u janë bashkuar koalicioneve duke shprehur gatishmërinë e tyre për bashkëpunim.

- **Shpërndarja e fletëpalosjeve:** Anëtarët e koalicioneve kanë shpërndarë fletëpalosje informuese tek anëtarët dhe strukturat e komunitetit, për të prezantuar misionin dhe vizionin e koalicionit dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e parandalimit dhe ndërhyrjes.

- **Trajnimet për ngritjen e koalicioneve:** YWCA of Albania dhe CADCA organizuan trajnimet e dyta dhe të treta për krijimin e koalicioneve në Kukës, Lezhë, Berat dhe Tiranë. Temat e trajtuara në këto trajnime përfshinin vlerësimin e komunitetit, modelet logjike, strategjitë gjithëpërfshirëse dhe elementët thelbësorë të vlerësimit të komunitetit, në mënyrë që pjesëmarrësit të pajiseshin me informacionin e duhur për të trajtuar në mënyrë efektive abuzimin me substancat.

- **Marrëveshjet e bashkëpunimit:** YWCA finalizoi marrëveshjet e bashkëpunimit me katër bashkitë për ngritjen e koalicioneve, ku paraqiten planet, politikat dhe strategjitë për reduktimin e normave të konsumit të drogës përmes fuqizimit, trajnimit dhe mbështetjes.

- **Aktivitetet ndërgjegjësuese:** Koalicionet organizuan aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese përgjatë vitit, si aktiviteti i realizuar nga DMA Shkodër për promovimin e një komuniteti të shëndetshëm dhe pa drogë përmes formave të ndryshme të artit, apo eventit lançues i CAD Tirana, me në fokus nxënësit e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare për të rritur ndërgjegjësimin e tyre ndaj efekteve negative të përdorimit të drogës dhe punës së koalicionit për parandalimin e këtij fenomeni.

Këto aktivitete dhe arritje dëshmojnë angazhimin e YWCA of Albania dhe CADCA për të reduktuar abuzimin me substancat dhe për të krijuar komunitete reziliente dhe mbështetëse në të gjithë Shqipërinë. Nëpërmjet bashkëpunimit, edukimit dhe angazhimit të komunitetit, këto anëtarët e këtyre koalicioneve punojnë së bashku për të sjellë ndryshim të prekshëm në jetën e individëve dhe familjeve që përballen me fenomenin e abuzimit me substancat.

RAPORTI NARRATIVI VJETOR



Përmbledhje: Përfituesit e programeve të YWCA

<i>Programi</i>	<i>Gra dhe vajza</i>	<i>Djem dhe burra</i>
Ekstremizmi i dhunshëm (Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve)	1000	200
Edukimi (Sesione informimi dhe mbështetje psikologjike)	800 prindër Afganë	500 prindër Afganë
Edukimi (Qasja formale e edukimit dhe mbështetje psikologjike)	80 fëmijë Afganë	100 fëmijë Afganë
Shëndeti (Këshillim psikologjik online falas për gratë e diagnostikuara me kancer në gjë dhe familjarët e tyre)	100	
Shëndeti (Aktivitete ndërgjegjësuere në lidhje me kancerin e gjirit)	1500 përfaqësues të komunitetit	500 përfaqësues të komunitetit
Trafikimi i qenieve njerëzore (Informim dhe fuqizim)	744 përfitues të ndihmës ekonomike	241 përfitues të ndihmës ekonomike
Trafikimi i qenieve njerëzore (Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve)	77 punonjës	16 punonjës
Koalicionet me bazë komunitare (Ngritje kapacitetesh)	90 përfaqësues të 12 sektorëve të komunitetit	43 përfaqësues të 12 sektorëve të komunitetit
Koalicionet me bazë komunitare (Ndërgjegjësim dhe fuqizim)	360 përfaqësues të komunitetit	140 përfaqësues të komunitetit